



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.69

6 qershor

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 423 datë 26.5.2011	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 29.4.2011 të Këshillit të Ministrave “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e Forcave Ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare-amfibe “Albanian Lion, 2011”” 2751
Vendim i Kuvendit nr.99, datë 26.5.2011	Për ngritjen e Nënkomisionit për Çështjet Gjinore dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë 2751
Vendim i Kuvendit nr.100, datë 26.5.2011	Për ngritjen e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut 2752
Vendim i Kuvendit nr.101, datë 26.5.2011	Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar 2752
Rezolutë e Kuvendit datë 26.5.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2010 2753
Rezolutë e Kuvendit datë 26.5.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2010 2754
Rezolutë e Kuvendit datë 26.5.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2010 2755
Rezolutë e Kuvendit datë 26.5.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2010 2755
Rezolutë e Kuvendit datë 26.5.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2010 2756

Rezolutë e Kuvendit datë 26.5.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2010	2758
Vendim i KM nr.367, datë 13.5.2011	Për një shtesë në vendimin nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	2759
Vendim i ERE nr.31, datë 31.3.2011	Mbi kontratën për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a., (furnizuesi publik me pakicë) për periudhën 1.1.2011 deri më 31.12.2011.....	2760
Vendim i ERE nr.47, datë 24.5.2011	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2011 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike	2771
Vendim i ERE nr.48, datë 24.5.2011	Për licencimin e shoqërisë “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike	2774
Vendim i ERE nr.49, datë 24.5.2011	Për fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar	2775
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Halil Rustami	2775
	Vendim për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Lejla Lamaj.....	2775
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sadetin Sharkiqi.	2775

LIGJ
Nr.10 423, datë 26.5.2011

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2, DATË 29.4.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË BRITANISË SË MADHE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT DETARE-AMFIBE “ALBANIAN LION, 2011””

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 29.4.2011 i Këshillit të Ministrave “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e Forcave Ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare-amfibe “Albanian Lion, 2011””.

Shpallur me dekretin nr.7007, datë 31.5.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

VENDIM
Nr.99, datë 26.5.2011

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR ÇËSHTJET GJINORE DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 55 pika 1, 19 pika 2 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Nënkomisioni për Çështjet Gjinore dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, në përbërje të Komisionit të Përherëshëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni janë çështjet gjinore dhe mbrojtja e fëmijëve.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

1. Albana Vokshi (PD)
2. Kosta Barka (PD)
3. Mehmet Xheka (LSI)
4. (PS)
5. (PS)

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.100, datë 26.5.2011

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 55 pika 1, 19 pika 2 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni janë të drejtat e njeriut.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

1. Arenca Trashani (PD)
2. Viktor Gumi (PD)
3. Mesila Doda (PD)
4. (PS)
5. (PS)

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.101, datë 26.5.2011

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR ÇAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për çaktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, në pikën I bëhen këto shtesa:

I. Deputeti Aurel Bylykbashi caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Deputeti Kosta Barka caktohet anëtar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Deputeti Ndrçim Babasi caktohet anëtar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbështetur në vijimësi Komisionin e Shërbimit Civil si institucion i pavarur, që ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” ka përcaktuar për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e shërbimit civil në nivel qendror e vendor;

Duke këmbëngulur për krijimin e një performance të plotë, transparente dhe të përgjegjshme të këtij Komisioni, me qëllim bërjen efiçente të veprimtarisë së tij;

Duke kërkuar me insistim që KSHC-ja të jetë promotor i zhvillimit të reformave në administratën publike, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

Konstaton se për vitin 2010:

- Veprimtaria e KSHC-së gjatë vitit 2010 ka tregues të kthimit në normalitet të funksionimit të tij;

- Trupa e re e kompozuar e KSHC-së është angazhuar në shqyrtimin e dosjeve të prapambetura, si dhe ka arritur të kthejë brenda afateve ligjore trajtimin e ankesave dhe vendimmarrjen e tyre;

- Raportimi i KSHC-së për vitin 2010 ka një përmirësim të lehtë në drejtim të konstatimit dhe interpretimit të problematikës dhe trajtimit të parimeve thelbësore, mbi të cilat është ndërtuar ligji, por i mungon analiza statistikore e detajuar në lidhjet shkak-pasojë të gjendjes së instituteve të ligjit për shërbimin civil;

- Veprimtaria e këtij institucioni nuk ka përmbushur objektivin ligjor në lidhje me ushtrimin e mbikëqyrjes në institucionet e ndryshme të administratës publike;

- Nuk ka tregues në përmirësimin e situatës së zbatueshmërisë së instituteve të shërbimit civil në administratën vendore dhe institucionet e pavarura;

- Nuk ka aplikuar mekanizmat ligjorë, me qëllim forcimin e kapaciteteve të tij si institucion që mbron të drejtat e ankuesve, subjekte të ligjit për shërbimin civil;

- Nuk ka pasur promovim të veprimtarisë së institucionit, në kuadër të informimit dhe publikimit të informacionit të nevojshëm ligjor dhe të ecurisë së vendimeve të trajtuara prej tij.

Kërkon nga Komisioni i Shërbimit Civil për vitin 2011:

- Përkushtimin dhe angazhimin maksimal të KSHC-së në drejtim të detyrave për mbështetjen e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike;

- Forcimin e kapaciteteve dhe instrumenteve ligjore për të përmirësuar zbatimin e vendimeve të tij dhe kryerjen e funksionit të mbikëqyrjes. Kuvendi kërkon nisjen e procedurave për plotësimin e vakancës;

- Monitorim më të thelluar të shërbimit civil, me qëllim parandalimin e shkeljeve dhe zgjidhjen e problematikave të zbatueshmërisë së instituteve të ndryshme të shërbimit civil në të gjitha nivelet e administratës publike;

- Rritjen e performancës së veprimtarisë së tij në tërësi dhe atë të çdo anëtar, duke synuar rritjen e efiçencës institucionale, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së administratës publike në të gjitha nivelet;

- Rritjen e shkallës së bashkëveprimit dhe koordinimit me institucionet e tjera menaxhuese në shërbimin civil dhe kontrolluese në administratën publike, në mënyrë të veçantë ky bashkëpunim duhet të jetë më i spikatur me Departamentin e Administratës Publike;

- Intensifikimin e trajnimeve me një fushë të gjerë të kategorive të nëpunësve civilë në të gjitha nivelet e administratës publike, lidhur me zbatimin dhe respektimin e instituteve të ndryshme të shërbimit civil;

- Rritjen cilësore të metodologjisë së raportimit në Kuvend, si dhe pasqyrimin e rekordeve në shkallët e ndryshme të gjyqësorit, në mënyrë të veçantë për sa i përket ekzekutimit të vendimeve.

26 maj 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin e Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues i konsoliduar në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë, që vepron i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë;

Duke mbështetur rolin e këtij institucioni për ngritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës publike, organeve të drejtësisë, gjyqësorit dhe prokurorisë në raport me qytetarët;

Duke nxitur angazhimin e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të njeriut në Shqipëri në të gjitha nivelet e administratës publike;

Duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e këtij institucioni në funksion të përmirësimit dhe arritjes së standardeve më të larta në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe kontributit të dhënë për përmirësimin e legjislacionit vendas, sipas frymës së standardeve ndërkombëtare;

Konstaton se për vitin 2010:

- Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010 ka konsistuar në evidentimin dhe trajtimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me standardet e të drejtave të njeriut në Shqipëri;

- Avokati i Popullit ka punuar për realizimin e objektivave, sipas rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, duke reflektuar në veprimtarinë e vitit 2010 frymën e kësaj rezolute, duke paraqitur një raport më të koncentruar, duke i kushtuar më tepër hapësirë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe analizës për gjendjen aktuale të tyre;

- Ka pasur një angazhim publik në median e shkruar dhe atë elektronike, si dhe angazhim të këtij institucioni në aktivitete që kanë për synim sensibilizimin e publikut;

- Njësia për Parandalimin e Torturës ka pasur rritje të performancës së punës në raport me vitet e kaluara;

- Është rritur bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë, duke informuar në mënyrë periodike shërbimin e monitorimit të institucioneve të pavarura, lidhur me ecurinë e punës në këtë institucion;

- Ka ushtruar kompetencat ligjore lidhur me rekomandimet për ndërhyrje, me qëllim përmirësimin e legjislacionit;

- Ka pasur një rënie të numrit të ankesave në raport me vitet e kaluara, sikurse rezulton dhe nga raporti i vitit 2010.

Kërkon nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2011:

- Të ketë një analizë më shteruese të të drejtave të njeriut në vend, si dhe konkluzionet të mbështeten në një metodologji që ndërthur tregues sasiore dhe cilësore, duke paraqitur të dhëna statistikore për çdo të drejtë;

- Rritjen e rolit sensibilizues të Avokatit të Popullit, me qëllim informimin e publikut në lidhje me rolin dhe kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit;

- Trajtim më të detajuar për evidentimin e problematikave të pushtetit vendor, në mënyrë të veçantë për bashkitë dhe komunat, me qëllim zbatimin e legjislacionit të qeverisjes vendore, për respektimin e parimit të decentralizimit, për ofrimin e shërbimeve për shtetasit në nivel vendor etj.;

- Ushtrimin e kompetencave ligjore, duke bërë kallëzime penale ndaj nëpunësve të administratës dhe të drejtësisë kur konstatohen elemente të veprave penale;

- Bashkëpunim më të ngushtë me Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, për referim masash administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë kur konstatohen shkelje ligjore;

- Rritjen e ndjekjes së rasteve kryesisht me iniciativë nga Avokati i Popullit;

- Rritjen e rolit monitorues për rekomandimet e bëra dhe masat e propozuara nga Avokati i Popullit drejtuar institucioneve shtetërore dhe administratës publike.

26 maj 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- Veprimtaria e KKRT-së është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- KKRT-ja ka arritur të dukshme në zbatimin e kërkesave të Kuvendit të Shqipërisë, të shprehura në rezolutën e vlerësimit të punës së këtij institucioni për vitin 2009.

Kuvendi vlerëson se:

- KKRT-ja gjatë vitit 2010 ka kontribuar duke marrë pjesë aktivisht në procesin e hartimit të projektligjit “Për transmetimet me zë dhe/ose me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ka përqendruar punën e saj në rritjen e efikasitetit ndaj luftës kundër piraterisë televizive;
- Ka ushtruar kontrolle të vazhdueshme dhe ka vendosur sanksione ndaj shkelësve të ligjit, duke rritur në këtë mënyrë garancitë për një konkurrencë të ndershme;
- Ka bërë një punë intensive në procesin e finalizimit të “Strategjisë së kalimit nga sistemi analog në atë numerik”.

Kuvendi kërkon nga KKRT-ja:

- Forcimin e kapaciteteve kontrolluese dhe ndëshkimore në luftën kundër piraterisë, falsifikimit dhe respektimit të të drejtave të autorit;
- Monitorimin, në bashkëpunim me KQZ-në, për pasqyrimin e drejtë dhe të paanshëm të zgjedhjeve lokale;
- Koordinim më të mirë me organet e tjera zbatuese dhe mbështetëse të parashikuara në ligj;
- Përshtatjen e strukturës ekzistuese me kërkesat e ligjit të ri, pas miratimit të tij nga Kuvendi;
- Bërjen efiçente të sistemit të monitorimit në distancë;
- Marrjen e masave për vjeljen e detyrimeve nga subjektet debitore të taksave apo gjobave.

26 maj 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-SË PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- Këshilli Drejtues i RTSH-së ka paraqitur brenda afatit raportin “Mbi veprimtarinë vjetore të RTSH-së për vitin 2010”, në zbatim të nenit 93 pika 12 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Këshilli Drejtues i RTSH-së është impenjuar në vazhdimësi për ngritjen e nivelit të RTSH-së në kushtet e konkurrencës së operatorëve të tjerë në tregun mediatik, duke bërë përpjekje për përmirësimin e parametrave që ndikojnë në ngritjen e imazhit të këtij institucioni tepër të rëndësishëm të vendit;
- Këshilli Drejtues i RTSH-së vëmendje të posaçme i ka kushtuar punës së strukturave drejtuese të RTSH-së për thellimin e procesit të reformimit të këtij institucioni, si një institucion kombëtar publik, siç e përcakton ligji;
- Siç është nënvizuar dhe në raportin e Këshillit Drejtues të RTSH-së, Kuvendi vlerëson përmirësimin e situatës financiare në shumën e 353 milionë lekëve, ose 65 për qind më shumë se në vitin 2009, të ardhura këto kryesisht si rrjedhojë e arkëtimit të tarifës së aparatit marrës televiziv dhe të përdorura në funksion të prodhimit dhe të investimeve;

2755

- RTSH-ja, sidomos gjatë vitit 2010 e në vazhdim, po punon intensivisht për përmirësimin e parametrave cilësorë në shërbim të teleshikuesve. Gjatë vitit 2010 ka vijuar përmirësimi i strukturës programore, përmes rifreskimit të ekranit me emisione cilësore, që kanë rritur shikueshmërinë e publikut.

Kuvendi vlerëson se:

- Në programet e RTSH-së vërehen arritje në drejtim të rritjes së pavarësisë editoriale;
- Përmirësimi sa më i shpejtë i kuadrit ligjor është i domosdoshëm në rritjen e efikasitetit të strukturave të këtij institucioni;
- Në dobi të procesit të nisur për përmirësimin e teknologjisë radiotelevizive dhe kualifikimit teknik e profesional të personelit të RTSH-së, nga ky institucion shumë i rëndësishëm, duhet një mbështetje më e madhe nga Buxheti i Shtetit;
- Duke vlerësuar përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e strukturës programore të RTSH-së, Kuvendi nxit përdorimin e formave sa më efektive gjithëpërfshirëse të dialogimit qytetar, të cilat mundësojnë ndjekjen në dinamikë nga teleshikuesit dhe dëgjuesit ndaj këtij operatori;
- Një vend të rëndësishëm në emisionet radiotelevizive duhet të zënë emisionet për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara shqisore;
- Këshilli Drejtues dhe drejtuesit e RTSH-së vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojnë rinovimit të teknologjisë digjitale të RTSH-së dhe përshtatjes të saj me stafin e kualifikuar profesional;
- Strukturat e RTSH-së të rrisin ndjeshëm efektivitetin e punës së tyre për rritjen e buxhetit të këtij institucioni, duke siguruar fondet financiare jo vetëm nga Buxheti i Shtetit dhe taksa mbi aparatat marrës, por dhe nga një larmi kontratash me palët e treta për transmetime të ndryshme;
- Kuvendi vëren se nga Këshilli Drejtues i RTSH-së nuk është zbatuar neni 88 pika 6 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, lidhur me hedhjen e shortit për përcaktimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së.

26 maj 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)
PËR VITIN 2010**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin e Entit Rregullator të Energjisë, si autoriteti i vetëm dhe i pavarur rregullator në vend për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

Duke vlerësuar arritjen tashmë disavjeçare të Qeverisë për furnizimin pa ndërprerje të konsumatorëve me energji elektrike;

Duke mbështetur strategjinë e qartë dhe të suksesshme për të garantuar këtë furnizim me siguri të lartë dhe në mënyrë të qëndrueshme afatgjatë, nëpërmjet rritjes së shkallës së shfrytëzimit me përparësi të rezervës hidroenergjetike të vendit dhe diversifikimit të burimeve të tjera gjeneruese, miqësore ndaj mjedisit dhe me leverdi ekonomike;

Duke vënë në dukje se në efektivitetin e lartë të shfrytëzimit të rezervës hidroenergjetike në vitin 2010, krahas prurjeve të jashtëzakonshme, ndikoi edhe efekti i shkallës së lartë të gatishmërisë së HEC-ve të sistemit energjetik;

Duke njohur që koeficienti vjetor i efektivitetit për sistemin e shpërndarjes vazhdon të mbetet shumë i ulët;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishme punën për realizimin e mundësisë së furnizimit të vendit me gaz natyror, nëpërmjet alternativave më të favorshme dhe për përgatitjen e kuadrit rregullator në këtë fushë;

Duke njohur dhe vlerësuar ndjeshmërinë publike për çmimet e energjisë dhe rolin e ERE-së në mbrojtjen e konsumatorëve;

Konstaton se ERE në vitin 2010:

- Nëpërmjet procedurave ligjore transparente ka kryer procesin e licencimit të 12 shoqërive private për të realizuar prodhimin e energjisë elektrike në 17 HEC-e me fuqi të instaluar prej rreth 64 MW;

- Ka ushtruar në vazhdimësi autoritetin dhe detyrimin e saj për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e operatorëve të licencuar, në lidhje me zbatimin e detyrimeve të tyre ligjore;

- Ka trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, me paanshmëri dhe brenda afateve ligjore, ankesat e konsumatorëve, duke marrë vendimet përkatëse për shmangien e abuzimeve dhe të arbitraritetit të vërejtur në shumë raste në procedurën e ndjekur nga “CEZ Shpërndarje” sh.a. për aplikimin e faturave për “dëmin ekonomik” dhe “energjinë e pamatur”;

- Ka qenë e vëmendshme në monitorimin e cilësisë së shërbimit dhe në identifikimin e problemeve konkrete të furnizimit me energji elektrike të klientëve;

- Ka rritur përpjekjet për informimin e një publiku të gjerë për kushtet e kryerjes së shërbimeve nga kompanitë e licencuara në sektorin e energjisë, me qëllim që të sigurojë një transparencë maksimale në funksion të përmirësimit të shërbimeve të ofruara;

- Ka vazhduar plotësimin e kuadrit rregullator në sektorin e gazit natyror;

- Mbështetur në metodologjinë përkatëse, ka kryer në kohë përcaktimin e tarifave të reja për veprimtaritë e prodhimit, furnizimit publik me shumicë, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike për klientët tariforë;

- Ka kryer në vazhdimësi informimin e Kuvendit për zhvillimet korente në sektorin e energjisë dhe ka ndihmuar me mendime të vlefshme në diskutimin e përmirësimeve përkatëse ligjore;

- Ka bashkëpunuar në mënyrë efektive me institucionet e tjera shtetërore për zgjidhjen e çështjeve dhe sfidave të ndeshura në procesin e rregullimit të sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Kërkon që ERE për vitin 2011:

- Të vazhdojë t'i kushtojë vëmendje monitorimit me efikasitet të tregut të energjisë elektrike dhe të licencuarve në këtë treg, si dhe ecurisë së sigurisë të furnizimit të vendit me energji elektrike;

- Të vazhdojë t'i kushtojë vëmendje mbrojtjes së konsumatorit, duke i garantuar atij cilësinë e shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit e vazhdueshëm të energjisë elektrike, transparencë, mirinformim dhe trajtim me paanësi të ankesave, ndër të tjera, duke përfunduar dhe vënë në zbatim edhe kontratën e re të furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë;

- Të përfundojë e të miratojë rregulloren për cilësinë e shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike, duke përcaktuar rregullat dhe detyrimet e ndërsjella në rastet e mosrespektimit të tyre nga furnizuesit me energji elektrike dhe përfituesit e shërbimit;

- Të specifikojë procedurat dhe kriteret e ankandit për alokimin e kapaciteteve disponibël të interkoneksionit ndërmjet zonës së kontrollit të OST sh.a. dhe operatorëve të transmetimit të vendeve fqinje;

- Të angazhohet në nxitjen e konkurrencës mes të licencuarve në tregun e energjisë elektrike;

- Të vazhdojë të monitorojë me kujdes e në mënyrë të veçantë përmbushjen e objektivave të përcaktuar për operatorin “CEZ Shpërndarje”, në lidhje me reduktimin e humbjeve në rrjet, rritjen e arkëtimeve, realizimin e investimeve dhe mbrojtjen e konsumatorit;

- Të kryejë analiza të sakta të treguesve financiarë të të licencuarve më të mëdhenj në tregun e energjisë elektrike;

- Të vazhdojë të angazhohet në plotësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator për sektorin e gazit natyror dhe në mbështetjen e projekteve me interes për investime në infrastrukturën e tij në vendin tonë.

26 maj 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke njohur tregun e komunikimeve elektronike si një treg me ritme shumë të shpejta rritjeje, sidomos në segmentet e telefonisë së lëvizshme e të internetit dhe me ndikim të madh në ekonominë e vendit, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë në këtë treg;

Duke vlerësuar rolin e AKEP-së në mbikëqyrjen me profesionalizëm dhe me paanësi të tregut të komunikimeve elektronike;

Duke vlerësuar punën e AKEP-së në reduktimin e tarifave celulare, si dhe të atyre për ofrimin e aksesit *broadband* në internet;

Duke vlerësuar punën profesionale të AKEP-së për sigurimin e kuadrit të nevojshëm rregullator për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike, në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike;

Duke vlerësuar punën e AKEP-së për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të standardit 3G, mbështetur në teknologjinë UMTS, në bazë të një procesi transparent, duke i hapur rrugë tregut të shërbimeve “*wireless*” me bandë të gjerë;

Konstaton se AKEP-ja:

- Ka ndikuar me punën e vet në reduktimin e tarifave të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike;

- Ka realizuar punën rregullatore për analizën e tregut të telefonisë së lëvizshme, si dhe për marrjen e vendimeve për shpalljen Operator me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet e telefonisë së lëvizshme dhe atë fikse, duke përcaktuar masa rregulluese që kanë të bëjnë me transparencën, mosdiskriminimin dhe dhënien e aksesit dhe orientimit në kosto të tarifave;

- Ka realizuar metodën e orientimit të tarifave në kosto (BU-LRAIC), si dhe ka kryer këshillimin publik për telefoninë e lëvizshme, por pa realizuar vendimet për rregullimin me reduktim të përshkallëzuar të tarifave të terminimit dhe origjinimit në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, sipas kësaj metode;

- Ka realizuar legjislacionin rregullator për aksesin dhe interkonjeksionin (RIO), duke shmangur rritjen e kostove administrative dhe siguruar përmirësimin e cilësisë së shërbimeve;

- Ka përmirësuar punën në veprimtarinë inspektuese dhe monitoruese të ushtruar për vitin 2010, por ka pasur vonesa në miratimin e legjislacionit rregullator për këtë veprimtari;

- Ka kryer punë të mirë për administrimin me efikasitet të spektrit të frekuencave;

- Nuk ka realizuar akoma sigurimin e ofrimit të portabilitetit të numrit, një kërkesë kjo e rezolutës së vitit 2010 të Kuvendit;

- Ka pasur vonesa në vendimmarrje për procesin e orientimit në kosto të tarifave për Albtelekomin;

- Nuk ka përmbushur detyrimin për shërbimin universal, një kërkesë kjo e rezolutës së vitit 2010 të Kuvendit.

Kërkon që AKEP-ja për vitin 2011:

- Të vazhdojë forcimin e pozitave të veta për mbikëqyrjen me transparencë, pavarësi dhe profesionalizëm të mbarëvajtjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe postare;

- Të përfshijë në programin e vet të punës detyrimet që rrjedhin nga “Dokumenti i politikave për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

- Të angazhohet në implementimin e shërbimit universal, si e vetmja mundësi për ofrimin e shërbimeve bazë edhe në ato zona ku këto shërbime mungojnë apo ofrohen në mënyrë të pamjaftueshme;

- Të angazhohet në përmirësimin e legjislacionit rregullator të pamiruar akoma për komunikimet elektronike, si dhe për legjislacionin rregullator për shërbimin postar;

- Të angazhohet në sigurimin e ofrimit të portabilitetit të numrit;

- Të angazhohet në marrjen e masave për uljen e mëtejshme të tarifave të shërbimit të telefonisë fikse, të lëvizshme dhe të internetit;

- Të angazhohet në dhënien e kapaciteteve të lira të operatorit të shpallur OFNT Albtelekom operatorëve alternativë, veçanërisht fibrat optike, por pa përjashtuar edhe kapacitete të tjera LLU;
- Të angazhohet që, brenda muajit nëntor 2011, të përcaktojë strategjinë e dhënies së licencës 3G për të gjithë operatorët e tjerë;
- Të angazhohet në përmirësimin e kuadrit rregullator për statistikën, si dhe në mbledhjen e të dhënave statistikore sa më të sakta dhe sa më profesionale në lidhje me këtë treg.

26 maj 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.367, datë 13.5.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR
HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 2 e 20 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen “Formati tip nr.5, lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, të përmendur në pikën 9 të kreut II të vendimit nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen nënndarjet e mëposhtme:

- “i) Rusia me dokumentin pasaportë, për periudhën qershor deri më 31 tetor 2011;
- ii) Ukrainë, Armeni, Azerbajxhan, Kazakistan, me dokumentin pasaportë, si dhe mbajtësit e dokumenteve të udhëtimit, të lëshuara në territorin e Tajvanit, Republika Popullore e Kinës;
- ii) Arabi Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katar, Oman, Bahrej, Kuvajt, ku të zbatohet i njëjti regjim vizash që këto shtete kanë me Bashkimin Europian.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.31, datë 31.3.2011

**MBI KONTRATËN PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE”
SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUdhËN 1.1.2011 DERI MË 31.12.2011**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 germa “A”, pika 2 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, pikës V.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 31.3.2011, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s mbi kontratën “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2011 deri më 31.12.2011”,

Konstatohet se:

Palët e kësaj kontrate, KESH sh.a./FPSH dhe OSSH/FPP, janë të licencuara nga ERE, përkatësisht:

- “CEZ shpërndarje” sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.9, datë 25.1.2008, të ndryshuar (në atë kohë OSSH sh.a.).

- “KESH” sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë, të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.11, datë 23.6.2006, të ndryshuar.

- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe “CEZ shpërndarje” sh.a. (FPP) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.

- Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

- Kërkesa e “CEZ shpërndarje” sh.a., që KESH sh.a. të heqë dorë nga garancia financiare, do të kërkonte më parë rishikim të vendimit të ERE-s nr.72, datë 24.6.2008 “Për miratimin e kontratës tip për furnizimin me energji elektrike ndërmjet FPSH dhe FPP”, pasi garancia financiare është element i përcaktuar në pikën 15 të kontratës tip të miratuar nga ERE. Garancia financiare është një element gjerësisht i përdorur në praktikën tregtare. “CEZ shpërndarje” sh.a. me performancën e saj të deritanishme në marrëdhëniet me KESH sh.a. nuk ka demonstruar korrektesë në shlyerjen e pagesave ndaj FPSH-së, e cila të mund të justifikonte kërkesën për heqjen e garancisë financiare nga kontrata. “CEZ shpërndarje” sh.a. e kushtëzon vendosjen e garancisë financiare me vendosjen e garancisë së performancës, vendosja e së cilës është pranuar nga KESH sh.a. me shkresën nr.7691/8 prot., datë 15.2.2011.

- Sasia e energjisë elektrike për t’u livruar për efekt të zbatimit të kësaj kontrate është sasia 4.235 GWh, e përllogaritur në përpurthje me planifikimin për efekt të llogaritjes së tarifës së furnizimit publik me shumicë miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.97, datë 7.12.2010.

- Kryerja e pagesës për livrimin e energjisë elektrike sipas opsionit “a”, të parashikuar në modelin e kontratës tip të miratuar nga ERE (në ditën e 30-të të muajit kalendarik dhe nëse nuk përkon me ditë pune menjëherë në ditën më pas) është në një linjë me mbledhjen e pagesave nga “CEZ shpërndarje” në kontratat e saj të furnizimit me konsumatorët tariforë të energjisë elektrike.

- Lidhur me problemin e devijimeve, balancimit vërehet se nuk është e njëjta gjë me sasitë për planifikim të energjisë elektrike. Në kuptim të “Rregullave të tregut”, pika VII, balancimet trajtohen sipas kapitullit VII, rregullat për tregun balancues, dhe kanë të bëjnë me devijimet orare. Nga ana tjetër, disbalancat duhet të trajtohen në një kohë të dytë, praktikë kjo e pranuar nga ERE edhe në procesin e miratimit të kontratës së shërbimit ndërmjet OST sh.a. dhe “CEZ shpërndarje” sh.a., pasi ato janë objekt i rregullimit të një rregulloreje të veçantë dhe jo i kësaj kontrate.

- Në lidhje me skedulën e livrimit (nominimi fizik i programit) në përpurthje me pikën VI, 3.4 të “Rregullave të tregut”, nominimi fizik për ditën e nesërme duhet paraqitur në orën 13:00. Si të tillë, konstatohet të drejtë qëndrimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Për sa më sipër evidentuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës për furnizim me energji elektrike ndërmjet shoqërisë “KESH” sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. (furnizuesi publik me pakicë) për periudhën 1.1.2011–31.12.2011, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011 deri në datën 31 dhjetor 2011.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

KONTRATË

PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË KESH SHA DHE FURNIZUESIT ME PAKICË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR PERIUDHËN 1.1.2011 DERI MË 31.12.2011

Mes [furnizuesit publik me shumicë] KESH sh.a., me zyrë në Tiranë, të regjistruar sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.12728, datë 6.11.1995 dhe [furnizuesit publik me pakicë] “CEZ shpërndarje” sh.a., me zyrë në Tiranë, të regjistruar sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.38587, datë 19.6.2007 (referohen së bashku si “Palët” dhe më vete si “Pala”), hyrë në fuqi më 1 janar 2011.

1. Subjekti i kontratës

Kjo kontratë (që përfshin shtojcat e saj) drejton të gjitha transaksionet ku do të hyjnë palët për blerjen, shitjen, livrimin dhe pranimin e energjisë elektrike.

2. Përkufizimet dhe ndërtimi

1. Përkufizime: Termat e përdorur në kontratë do të kenë kuptimet e dhëna në shtojcën 1.

2. Interpretimi: Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për konvencencë dhe nuk prekin interpretimin e kontratës.

3. Referencat në kohë: Referencat në kohë do të jenë sipas kohës qendrore europiane (CET).

4. Përputhja me rregullat e tregut: Kjo kontratë, detyrimet dhe të drejtat e blerësit dhe shitësit, do të jenë subjekt i parashikimeve të “Rregullave të tregut”, të aprovuara dhe të modifikuara kohë pas kohe nga ERE. Në rast se ndonjë parashikim në këtë kontratë është në konflikt me ndonjë parashikim të “Rregullave të tregut”, atëherë do të paraprijnë këto të fundit.

3. Detyrimet e shitësit

1. Shitësi do të sigurojë të gjithë energjinë elektrike në sasinë 4.235 GWh, në përputhje me sasinë e energjisë elektrike të planifikuar për efekt të përlllogaritjes së tarifës së furnizuesit publik me shumicë për vitin 2011, në kohën dhe në sasinë, siç do t’ia tregojë blerësi shitësit sipas përcaktimeve të modelit dhe “Rregullave të tregut”. Kuptohet se sasia e energjisë elektrike për të cilën blerësi është i autorizuar nga shitësi do të jetë vlerësimi më i mirë i blerësit i ditës në avancë e ngarkesës së klientëve tariforë të blerësit, siç matet në ambientet e klientëve, përfshirë një vlerësim të ngarkesës për çdo orë.

2. Shitësi do të jetë përgjegjës për sigurimin e të gjithë kapacitetit, shërbimeve ndihmëse, dhe shërbimeve të transmetimit të kërkuara nga OST-ja ose që lidhen me shitjen dhe livrimin e energjisë elektrike të siguruar blerësit deri në pikën e livrimit, sipas tarifave të miratuara nga ERE.

4. Detyrimet e blerësit

1. Blerësi do të sigurojë vlerësimet e vitit në avancë, muajit në avancë, javës në avancë dhe ditës në avancë të kërkesave të tij për energji elektrike në një program që do të vendoset mes blerësit dhe shitësit.

2. Blerësi do t’i sigurojë shitësit të gjitha të dhënat që lidhen me formën e ngarkesës së klientit të disponueshme për blerësin.

3. Blerësi do të jetë përgjegjës për sigurimin e të gjithë kapacitetit, shërbimet ndihmëse dhe shërbimeve të transmetimit të kërkuara dhe të ofruara nga OST-ja dhe/ose që lidhen me blerjen e energjisë elektrike nga blerësi që nga pika e livrimit, një pjesë e të cilave përcaktohen në vijim në këtë marrëveshje, sipas tarifave të miratuara nga ERE”.

5. Detyrimet kryesore për furnizimin me energji elektrike

1. Livrimi dhe pranimit: Shitësi do të programojë, shesë dhe livrojë, ose do të bëjë të mundur të livrohët, dhe blerësi do të programojë, blejë dhe pranojë, ose do të bëjë të mundur të pranohët sasinë e kontratës në pikën e livrimit; dhe blerësi do t'i paguajë shitësit çmimin përkatës të kontratës.

2. Përkufizimi i programit: “Program” sipas zbatimit do të thotë veprimet e nevojshme për një palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit ose pranimit, që mund të përfshijnë nominimin, programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me palën tjetër, agjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës, dhe me OST-në, kur aplikohët, sasinë e kontratës, kapacitetin e kontratës, pikën e livrimit, programin e livrimit, periudhën totale të furnizimit, dhe çdo kusht tjetër përkatës të kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme të OST-së dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

6. Livrimi, matja, transmetimi dhe risku

1. Rryma/frekuenca/tensionet: Energjia elektrike do të livrohët me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në pikën përkatëse të livrimit, sipas standardeve të OST-së dhe OSSH-së, kur aplikohët, si dhe në përputhje me rregullat dhe kodet në fuqi.

2. Programet e livrimit: Sasia e energjisë elektrike që do të parashikohët nga blerësi të livrohët mbi baza vjetore, mujore, javore dhe ditore, në përputhje me “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”. Nominimi fizik për ditën e nesërme duhet paraqitur në orën 13:00 në përputhje me pikën VI, 3.4 të “Rregullave të tregut”.

3. Transferimi i të drejtave të titullit: Livrimi do të realizohët duke bërë të disponueshme sasinë e kontratës me kapacitetin e kontratës në pikën e livrimit. Livrimi dhe marrja në dorëzim e sasisë së kontratës dhe transferimi nga shitësi te blerësi i të gjitha të drejtave të lira dhe të qarta nga çdo pretendim i kundërt për to, do të zhvillohët në pikën e livrimit.

4. Matja e livrimeve të energjisë elektrike dhe marrjet në dorëzim: Çdo palë është përgjegjëse për të siguruar që livrimet dhe marrjet në dorëzim të energjisë elektrike të maten ose verifikohen me mjete që janë të evidentuara në mënyrë të arsyeshme, në përputhje me procedurat e OST-së dhe OSSH-së, kur është e aplikueshme, që drejtojnë në pikën përkatëse të livrimit.

5. Dokumentacioni i livrimeve aktuale dhe i marrjeve në dorëzim: Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, pala:

a) do t'i sigurojë palës tjetër dokumentacionin që posedon ose do të kontrollojë paraqitjen e programeve, sasive, livrimeve dhe marrjeve në dorëzim të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të kontratës individuale dhe livrimeve dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike; dhe

b) do të bëjë përpjekjet e veta të arsyeshme dhe të zellshme për të kërkuar dhe marrë nga OST-ja dhe OSSH-ja, kur aplikohët, dhe do të ndajë me palën kërkuese çdo dokumentacion shtesë të nevojshëm për të sistemuar mospërputhjet mes flukseve të programuara dhe atyre aktuale të energjisë elektrike.

6. Rimbursimi i kostove të jashtme: Në rast se njëra palë, me kërkesën e palës tjetër, ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga pala tjetër, pëson shpenzime të jashtme të arsyeshme, kur verifikon se pala tjetër nuk i ka kryer si duhet detyrimet e saj, sipas kushteve të kontratës, këto shpenzime do të rimbursohen me kërkesën e Palës që ka dështuar në performim.

7. Risqet e shitësit dhe blerësit: Shitësi do të marrë përsipër të gjitha risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, transmetimit dhe livrimit të sasisë së kontratës deri në pikën e livrimit. Blerësi do të marrë përsipër të gjitha risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të pranimit dhe transmetimit të sasisë së kontratës në/dhe nga pika e livrimit.

8. Pikat e livrimit: Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në sistemin e transmetimit të OST-së ose në sistemin e shpërndarjes të OSSH-së, sipas rastit, në pikat që mund të caktohen nga shitësi, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

7. Mosperformanca për shkak të forcës madhore

1. Përkufizimi i forcës madhore: Përveç se kur specifikohët ndryshe, “Forcë madhore” për qëllimet e kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të palës që pretendon forcën

madhore (pala pretenduese), që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që pala pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:

a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon palën pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose

b) pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të palës pretenduese lidhur me programimin sipas kontratës.

2. Çlirimi nga detyrimet e livrimit dhe pranimit: Nëse një palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë kontratave dhe kjo palë respekton kërkesat e pikës 7.3 (njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore), do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e palës pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo forcë madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikës 8 (zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim) nuk do t'i merret palës pretenduese lidhur me sasi të palivruara ose të pamarra.

3. Njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore: Pala pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi mëson për forcën madhore, do të njoftojë palën tjetër për fillimin e forcës madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jodetyruar mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala pretenduese do të përdorë të gjitha përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe gjatë vazhdimit të forcës madhore do t'i sigurojë palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur/dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

4. Efektet e forcës madhore mbi palën tjetër: Në rast dhe në atë shkallë që shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të forcës madhore, blerësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të forcës madhore, shitësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të livrimit.

8. Zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim

1. Paaftësia për livrim: Në atë shkallë që pala që ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike (pala livruese) nuk arrin të livrojë tërësisht ose pjesërisht sasinë e kontratës sipas kushteve të kontratës dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e forcës madhore ose nga mosperformanca e palës tjetër, pala livruese do t'i paguajë palës tjetër (pala pranuese), si kompensim për dëmtimet, një shumë të barabartë me kostot e shpenzimeve shtese, të arsyeshme, të argumentuara dhe të verifikueshme që pëson pala pranuese, furnizuesi publik me pakicë (FPP) si pasojë e paaftësisë për livrim energji elektrike te konsumatorët tariforë.

2. Kompensimi i detyrimeve për livrim të tepërt mbi planifikimin

Në shtesë të pikës 8.1 më sipër, devijimi i kërkesës reale nga ai i planifikuar, në atë shkallë që pala livruese livron energji elektrike më tepër se ajo e paraqitur nga pala pranuese (furnizuesi publik me pakicë), atëherë pala pranuese duhet t'i paguajë palës livruese, si kompensim, detyrimin për këtë sasi energjie të livruar më tepër, të barabartë me produktin e:

Sasisë së energjisë elektrike të livruar më tepër nga ajo e planifikuar dhe diferencës nëse është pozitive ndërmjet çmimit të energjisë elektrike të blerë në treg dhe atij të vendosur në këtë kontratë.

3. Kompensimi i devijimeve të humbjeve

Në rast se "CEZ shpërndarje"/furnizuesi publik me pakicë, ka importuar fizikisht një sasi energjie elektrike të ndryshme nga sasia e energjisë elektrike e barabartë me nivelin faktik të humbjeve të sistemit të shpërndarjes, sipas rregullave të përcaktuara në "Modelin e tregut të energjisë elektrike" dhe "Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike", atëherë palët do të kompensojnë njëra-tjetrën me energji elektrike, si më poshtë:

i) Në rastin e importit të një sasi më të madhe, KESH sh.a., do t'i kompensojë "CEZ shpërndarjes", këtë diferencë pozitive me energji elektrike deri në fund të muajit pasardhës të muajit në të cilin ka ndodhur devijimi;

ii) Në rastin e importit të një sasi më të vogël, "CEZ shpërndarje" do t'i kompensojë KESH sh.a. këtë diferencë negative me energji elektrike deri në fund të muajit pasardhës të muajit në të cilin ka ndodhur devijimi.

iii) Megjithatë palët rezervojnë të drejtën të kërkojnë në mënyrë të dokumentuar, brenda afatit të përcaktuar në pikat “i” dhe “ii”, ta bëjnë kompensimin me energji në një periudhë tjetër, në varësi të nevojave dhe mundësive të tyre, brenda një afati të ri kohor për të cilin duhet të bien dakord.

4. Paaftësia për pranim: Në atë shkallë që pala pranuese nuk arrin tërësisht ose pjesërisht të pranojë sasinë e kontratës në përputhje me kontratën, dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e forcës madhore ose nga mosperformanca e palës tjetër, pala pranuese do t'i paguajë palës livruese si kompensim për dëmet një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike të barabartë me produktin e:

a) shumës, nëse është pozitive, nëpërmjet së cilës çmimi i kontratës tejkalon çmimin me të cilin pala livruese është ose do të jetë në gjendje të shesë sasinë e energjisë elektrike të papranuar në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme; dhe

b) sasisë së energjisë elektrike të papranuar. Kjo shumë do të rritet nga çdo kosto rritëse e transmetimit dhe kostot e shpenzimit e tjera të arsyeshme dhe të verifikueshme që pëson pala livruese si rezultat i paaftësisë së palës pranuese.

5. Shumat e pagueshme: Shumat e pagueshme sipas pikës 8 do të faturohen dhe paguhën sipas pikës 13 (faturimi dhe pagesa).

9. Pezullimi i livrimit

Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera të disponueshme për një palë (Pala që përmbush detyrimet), nëse njëra palë (Pala që nuk përmbush detyrimet) nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas kontratës, ose nëse ajo ose garanti i kredisë nuk arrin ta sigurojë, zëvendësojë ose rrisë shumën e sigurisë së performancës së kërkuar, sipas kontratës ose çdo dokumenti mbështetës të kredisë, pala që përmbush detyrimet do të autorizohet, jo më parë se 3 (tri) ditë punë pas dërgimit të një njoftimi me shkrim palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë menjëherë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike (dhe të çlirohet (dhe jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit), sipas të gjitha kontratave individuale deri kur pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e zbatueshme) të gjitha shumave të papaguara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet. Pezullimi i livrimeve apo çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit, nga palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE-s.

10. Kohëzgjatja dhe të drejtat e përfundimit

Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në datën e miratimit nga ERE. Mund të përfundohet përpara datës së specifikuar në këtë kontratë, vetëm me miratimin e ERE-s.

11. Çmimi

1. Çmimi për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë 1.48 lekë/kwh , siç është aprovuar nga ERE, sipas vendimit nr.97, datë 7.12.2010 “Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2011.”

12. Kufizimi i përgjegjësisë financiare

1. Përjashtimi i përgjegjësisë financiare: Subjekt i pikave 12.2 dhe 12.3 dhe përveç kur lidhet me shumat e pagueshme sipas pikës 8 (zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim), një palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, kontraktorët dhe/ose agjentët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm (dëmet), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një kontrate individuale), që pëson pala tjetër sipas marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mospagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një pale ose punonjësve, zyrtarëve, kontraktorëve dhe/ose agjentëve të saj, përdorur nga kjo palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas kontratës.

2. Dëmi pasues dhe kufizimi i përgjegjësisë financiare: Subjekt i pikës 12.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas kontratës ose lidhur me të:

a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe

b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumat e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një palë, sipas çdo kontrate individuale përkatëse, me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 8 (zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim).

3. Mospagesa e qëllimshme, mashtrimi dhe të drejtat themelore: Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të palës për:

a) mospagesën e qëllimshme;

b) mashtrimin; ose

c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një pale.

4. Detyra për lehtësimin e humbjeve: Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i legjislacionit në fuqi, çdo palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë dëmet dhe premtion që do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo dëmi që mund të pësojë sipas kontratës ose lidhur me të.

13. Faturimi dhe pagesa

1. Fatura: Shitësi do t'i transmetojë blerësit gjatë muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike, sipas programit të livrimit për muajin e mëparshëm, një faturë që paraqet sasi të totale të energjisë elektrike, që u shitën prej tij sipas kontratës gjatë muajit të mëparshëm kalendarik. Lidhur me këtë faturë, pala mund të shprehë të gjitha shumat që zotëroheshin atëherë mes palëve, sipas kontratës përfshirë, por pa u kufizuar me të gjithë shumat e zotëruara për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, tarifat, pagesat, rimbursimet, dëmet, interesat dhe pagesa të tjera ose kredi mes palëve dhe, nëse është e zbatueshme, çdo shumë neto të detyrueshme për pagesë.

2. Pagesa të bëhet brenda 30 ditëve të muajit kalendarik dhe nëse dita e fundit nuk është ditë punë, ditën tjetër të punës.

3. Faturimi dhe pagesa e sasive të programuara të kontratës: Faturimi dhe pagesa do të bazohen në sasi të programuara të kontratës sipas gjithë programeve të zbatueshme të livrimit për muajin përkatës. Kur dhe nëse të dhënat bëhen të disponueshme dhe konfirmojnë që sasi të aktuale të energjisë elektrike të livruar dhe të marra ndryshojnë nga ato të caktuara në programet e livrimit, faturimi dhe pagesa do të rregullohen për të pasqyruar çdo devijim mes sasive të kontratës dhe livrimeve aktuale.

4. Interesi i mospagesës: Pagesat e vonuara do të mbledhin interesin nga data e detyrimit, duke e përfshirë edhe atë, por duke përjashtuar datën e pagesës me përqindje interesi. Për këtë qëllim "Përqindja e interesit" do të jetë norma e interesit që do të aplikohet për çdo ditë vonese të pagesës të jetë masa e Yield-it mesatar të bonove të thesarit me maturim 1-vjeçar të publikuar nga Banka e Shqipërisë + 3% në vit, të llogaritur nga data e përcaktuar në pikën 2 të nenit 13 të kontratës tip deri në datën e pagesës së shumës së papaguar të faturës.

5. Shumat e diskutueshme: Nëse një palë, me mirëbesim, vë në diskutim saktësinë e një fature, në datën e pagesës ose para saj do të japë një shpjegim me shkrim të bazës së diskutimit dhe do të paguajë shumën e plotë të faturuar jo më vonë se data e pagesës. Nëse çdo shumë e paguar me diskutim përcaktohet përfundimisht se nuk duhej paguar, kjo mbipagesë, me zgjedhjen e palës detyruese, do t'i kreditohet ose do t'i kthehet palës tjetër brenda 10 (dhjetë) ditëve pas këtij përcaktimi, së bashku me interesin e mbledhur me përqindjen e interesit nga data e pagimit të shumës, përfshirë edhe këtë datë, por duke përjashtuar datën 12 të kthimit ose kreditimit.

14. TVSH-ja dhe taksat

1. TVSH-ja: Të gjitha shumat e referuara në këtë kontratë përjashtojnë çdo vlerë të zbatueshme të taksës së shtuar (TVSH). Nëse TVSH-ja është e pagueshme për çdo shumë të tillë, blerësi do t'i paguajë shitësit një shumë të barabartë me TVSH-në me tarifën e zbatueshme. Një shumë e barabartë me TVSH-në e pagueshme nga një palë do të kërkohet për t'u paguar vetëm kur pala tjetër të sigurojë një faturë të vlefshme TVSH-je lidhur me atë shumë. Çdo palë, për aq sa e lejon ligji, do t'i sigurojë palës tjetër fatura TVSH-je shtesë, të vlefshme që kërkohen për qëllimet e kontratës.

2. Detyrimet e taksave të shitësit dhe blerësit: Shitësi do të paguajë ose shkaktojë pagesën e të gjitha taksave për sasinë e kontratës ose lidhur me të që del para transferimit të riskut dhe titullit në pikën e livrimit. Blerësi do të paguajë ose do të shkaktojë pagesën e të gjitha taksave në sasinë e kontratës ose lidhur me të, ose të kontratës individuale, që dalin gjatë ose pas transferimit të riskut dhe titullit në pikën e livrimit (përveç taksës direkte ose indirekte që lidhet me shitjen e sasisë së kontratës dhe është përgjegjësi ligjore e shitësit). Në rast se shitësi i kërkohet me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e blerësit, blerësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë shitësin për këtë taksë. Në rast se blerësi i kërkohet me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e shitësit, blerësi mund t'ia zbrësë shumën e kësaj takse nga shumat e detyrueshme shitësit, sipas kontratës dhe shitësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë blerësin lidhur me këto taksa të pazbritura. Nëse ndonjë taksë e re bëhet e zbatueshme ose një taksë ekzistuese rritet lidhur me kontratën dhe blerësi është në gjendje ta kalojë përmes një pale të tretë, blerësi do të jetë përgjegjës për këtë taksë të re ose të rritur.

3. Taksa e mbajtur: Pagesat lirë dhe qartë. Gjithë pagesat sipas një kontrate individuale do të bëhen pa mbajtje ose zbritje për llogari të çdo takse, përveç kur kjo mbajtje ose zbritje kërkohet me ligj. Nëse një pale i kërkohet të mbajë ose të zbresë taksën nga një pagesë që duhet të bëjë, atëherë ajo palë (pala paguese) do të njoftojë menjëherë palën tjetër (pala marrëse) për këtë kërkesë dhe do t'u paguajë autoriteteve të duhura të gjitha shumat e mbajtura ose të zbritura prej saj. Nëse mund të lëshohet një faturë ose provë tjetër që evidenton pagesën tek autoritetet, pala paguese do t'ia dorëzojë këtë provë (ose një kopje të certifikuar) palës marrëse.

4. Minimizimi i taksave: Të dyja palët do të përdorin përpjekje të arsyeshme për të administruar kontratën dhe për të zbatuar dispozitat e saj sipas synimit për minimizimin e akumulimit të detyrimeve për pagesën e taksës, kur është e arsyeshme dhe e mundur.

15. Garancitë dhe mbështetja e kredisë

Shitësi dhe blerësi janë të detyruar të lëshojnë në kuadrin e kësaj kontrate, përkatësisht:

Shitësi një garanci performance dhe blerësi një garanci financiare sipas termave të mposhtëm:

1. Garancia financiare: Për të mbuluar risqet e aftësisë paguese të blerësit ndaj shitësit lidhur me sasinë e energjisë elektrike të livruar për të siguruar plotësimin e menjëhershëm të të gjitha detyrimeve të tjera që rezultojnë nga kjo kontratë, blerësi do të ketë ngurtësuar 10 ditë kalendarike përpara muajit përkatës të livrimit, në favor të shitësit, garancinë bankare në vlerën monetare që i korrespondon sasisë mesatare mujore të energjisë elektrike të planifikuar për vitin 2011 (353 GWh), e cila do të jetë e vlefshme deri në datën e fundit të muajit pasardhës të muajit të livrimit të energjisë me çmim shitjeje, të përcaktuar sipas kësaj kontrate.

2. Garancia bankare duhet të lëshohet nga një bankë e nivelit të dytë e licencuar në vend.

16. Siguria e performancës

1. Në rast se shitësi dështon të përmbushë detyrimet e tij për livrimin e energjisë elektrike, sipas skedulit të paraqitur nga blerësi, për më shumë se tri ditë radhazi, atëherë blerësi ka të drejtë të kërkojë nga shitësi vendosjen e një garancie performance në formën e një garancie financiare në një nga bankat e nivelit të dytë të licencuar në vend, në vlerën që i korrespondon sasisë mesatare të energjisë elektrike të furnizuar në një javë (81 GWh) me çmimin e blerjes të miratuar nga ERE.

2. Pas marrjes së njoftimit me shkrim, pala tjetër brenda tri (3) ditëve punë do t'i sigurojë palës kërkuese sigurinë e kërkuar të performancës.

3. Ndryshimi i dëmshëm material: Një ndryshim i dëmshëm material do të ketë ndodhur nëse ka ndodhur një ose më shumë nga ngjarjet e specifikuar nga vetë palët.

17. Sigurimi i pasqyrave financiare dhe vlera neto e prekshme

1. Sigurimi i pasqyrave financiare: Përveç kur specifikohet ndryshe, nëse kërkohet nga njëra palë, pala tjetër do t'i dorëzojë asaj:

a) brenda 120 ditëve pas mbarimit të çdo viti fiskal, një kopje të raportit vjetor që përmban pasqyra financiare të audituara dhe të konsoliduara për këtë vit fiskal, për periudhën kur detyrimi i palës tjetër mbështetet nga garantuesi i kredisë ose nëse është palë e një marrëveshje kontrolli dhe transferimi të fitimit, nga garantuesi i kredisë ose pala kontrolluese, sipas rastit; dhe

b) brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas përfundimit të secilit nga tre tremujorët e tij fiskalë të çdo viti fiskal, një kopje të raportit tremujor, që përmban pasqyra financiare të paaudituar të konsoliduar.

2. Rënia e vlerës neto të prekshme: Sapo të bëhet e ndërgjegjshme për këtë rënie, çdo palë do të njoftojë menjëherë palën tjetër për ndodhinë e rënies së vlerës neto të prekshme ose vlerës neto të prekshme të garantuesit të kredisë ose palës kontrolluese, në një nivel nën shumën e specifikuar nga palët.

3. Parimet financiare: Në çdo rast, deklaratat financiare që referohen në pikën 17 do të përgatiten sipas parimeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

18. Transferimi

1. Ndalimi: Asnjëra palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kontratës një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme dhe me miratimin e ERE-s.

2. Transferimi te filialet: Çdo palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër, një filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga pala tjetër dhe, me kusht që çdo dokument mbështetës kredie i nxjerrë ose i vendosur në emër të palës transferuese të jetë rinxjerrë ose amenduar fillimisht për të mbështetur detyrimet e filialit në përfitim të palës tjetër.

19. Përfaqësimet dhe garancitë

Nëse specifikohet si e zbatueshme për palët, ajo palë përfaqëson dhe garanton në këtë mënyrë palën tjetër pas hyrjes në këtë kontratë për sa vijon:

a) se është një njësi e organizuar si duhet, që ekziston në mënyrë të arsyeshme dhe sipas ligjeve të juridiksionit të korporatës ose organizatës;

b) nënshkrimi dhe hyrja në kontratë, në çdo dokument mbështetës kredie ku është palë dhe në kryerjen e transaksioneve të shqyrtuara këtu, nuk do të shkelin asnjë dispozitë të dokumenteve kushtetuese;

c) ka pushtetin dhe është e autorizuar të ekzekutojë, shpërndajë dhe kryejë detyrimet sipas kontratës dhe çdo dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, livrimin, kryerjen dhe hyrjen në kontratë dhe ekzekutimin, livrimin dhe kryerjen e kontratës dhe se çdo dokument mbështetës kredie nuk shkel dhe nuk bie në konflikt me asnjë afat ose kusht tjetër të ndonjë kontrate ku është palë ose ndonjë dokument konstitucional, rregull, ligj ose rregullore në fuqi;

d) ka të gjitha autorizimet qeveritare dhe rregullatore, miratimet dhe pëlqimet e nevojshme për të kryer detyrimet sipas kontratës dhe çdo dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë; (e) ka negociuar, ka hyrë dhe ka ekzekutuar kontratën dhe çdo dokument mbështetës kredie ku është palë kryesore (dhe jo si agjent ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe);

e) hyn rregullisht në marrëveshje për tregtimin e energjisë elektrike, siç planifikohet nga kontrata, dhe e bën këtë mbi baza profesionale sipas linjës së vet kryesore të biznesit, dhe mund të karakterizohet në mënyrë të arsyeshme si palë profesioniste tregu;

f) vepron për llogari të vet (dhe jo si këshilltar, agjent, agjent ndërmjetës ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe), ka marrë vendimin e vet të pavarur për të hyrë në këtë kontratë dhe nëse kjo kontratë është e përshtatshme ose si duhet për të, bazuar në gjykimin e vet, nuk mbështetet mbi këshillën ose rekomandimet e palës tjetër për ta bërë këtë, dhe është e aftë për të vlerësuar meritat dhe kupton dhe pranon afatet, kushtet dhe risqet e kontratës;

g) pala tjetër nuk vepron si kujdestar apo këshilltar i saj;

h) nuk mbështetet në asnjë përfaqësim të bërë nga pala tjetër, përveç atyre të thëna shprehimisht në kontratë ose në dokumentin mbështetës të kredisë ku është palë;

i) lidhur me një palë që është njësi qeveritare ose sistem energjetik publik, kjo njësi qeveritare ose sistem energjetik publik përfaqëson dhe i garanton palës tjetër si më poshtë;

j) të gjitha aktet e nevojshme për ekzekutimin e vlefshëm, shpërndarjen dhe kryerjen e kontratës, përfshirë pa kufizim, ofertat konkurruese, njoftimin publik, zgjedhjen, referendumin, përvetësimin paraprak ose procedura të tjera të kërkuara që janë ndërmarrë ose kryer, ose do të ndërmerren dhe kryhen;

k) hyrja në kontratë dhe zbatimimi i saj nga një njësi qeveritare ose sistem energjetik publik bëhet për një qëllim të duhur publik brenda kuptimit të dokumenteve përkatëse konstitucionale ose qeveritare dhe legjislativoni në fuqi; dhe

l) afati i kontratës nuk zgjatet përtej ndonjë kufizimi të zbatueshëm të vendosur nga ndonjë dokument tjetër përkatës konstitucional ose qeveritar dhe nga legjislativoni në fuqi; dhe

m) lidhur me një palë, se nuk ka falimentuar, dhe nuk ka procedime ligjore ose administrative pezull ose kërcënuese, ku të jetë palë dhe që në dijeni të saj do të ndikonin materialisht në mënyrë të dëmshme aftësinë e saj për kryerjen e çdo detyrimi sipas kësaj kontrate ose ndonjë dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë, të tilla që ta bënin të falimentonte.

20. Legjislativoni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Legjislativoni në fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislativoni në fuqi.

2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me kontratën do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë, gjithashtu, zbatimin nga gjykata të të drejtave të saj kontraktuale.

21. Të ndryshme

1. Regjistrimi i bisedave telefonike: Çdo palë lejohet të regjistrojë bisedat telefonike të mbajtura lidhur me kontratën dhe t'i përdorë si provë. Çdo palë heq dorë nga çdo njoftim tjetër mbi këtë regjistrim dhe pranon se ka marrë të gjitha pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të vet për këto regjistrime.

2. Njoftimet dhe komunikimet: Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga palët, të gjitha njoftimet, deklaratat ose faturat e dërguara nga një palë tjetër, duhet të jenë me shkrim dhe duhen dorëzuar me letër (postë që arrin brenda 24-orësh ose korrier, postë e parapaguar) ose faksimile. Çdo palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:

a) nëse shpërndahen dorazi, ditën e punës ose ditën e parë të punës pas datës së livrimit nëse shpërndahen jo në ditën e punës;

b) nëse dërgohen me postë të klasit të parë, ditën e 2-të të punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në ditën e 5-të të punës pas datës së postimit; ose

c) nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17:00 (me orën e marrësit) në ditën e punës ose në orën 09:00 (me orën e marrësit) në ditën e parë të punës pas transmetimit.

3. Amendimet: Çdo amendim ose shtesë në këtë kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.

4. Pavlefshmëria e pjesshme: Nëse në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Palët ndërmarrin zëvendësimin e çdo dispozite të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme me një dispozitë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme që afrohet sa më shumë me dispozitën e pavlefshme lidhur me qëllimin e saj ekonomik, subjekt i aprovimit nga ERE.

5. Të drejtat e palës së tretë: Palët nuk presin që ndonjë palë e tretë të ketë të drejta ose të jetë e aftë të zbatojë kontratën dhe palët përjashtojnë për aq sa është e lejueshme nga legjislacioni në fuqi, çdo të drejtë të këtyre palëve të treta që mund të nënkuptohet.

22. Miratimi i ERE-s

1. Kjo kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.

2. Kjo kontratë miratohet me vendimin nr.31, datë 31.3.2011, dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2011.

Nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar si duhet i secilës palë në datën e hyrjes në fuqi.

[Emri i palës] [Emri i palës]

[Emri i nënshkruesve] [Emri i nënshkruesve]

[Titulli i nënshkruesve] [Titulli i nënshkruesve]

SHTOJCA 1 E KONTRATËS TERMAT E PËRCAKTUAR

Termat e përdorur në kontratë do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Pala pranuese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 8.1 (paaftësia për livrim) të kësaj kontrate;

“Filial” lidhur me një palë do të thotë një njësi e kontrolluar direkt ose indirekt nga ajo palë, çdo njësi që kontrollon direkt ose indirekt atë palë ose çdo njësi direkt ose indirekt nën kontrollin e përbashkët të një pale;

“Kontratë” ka kuptimin e specifikuar në pikën 1.1 (subjekti i kontratës);

“Çmimi referues alternativ i mallit” ka kuptimin, nëse ekziston, të specifikuar në çdo kontratë individuale që përmban një çmim të paqëndrueshëm;

“Dita e punës” do të thotë një ditë (përveç të shtunës dhe të dielës) në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila palë ka zyrën e saj të regjistruar;

“Blerës” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale;

“Data e llogaritjes” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale të çmimit të paqëndrueshëm;

“Metoda e llogaritjes” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale të çmimit të paqëndrueshëm;

“Koha qendrore europiane” ose “CET” do të thotë koha qendrore europiane dhe do të përfshijë kohën dimërore qendrore europiane dhe kohën verore qendrore europiane sipas zbatimit;

“Konfirmimi” ka kuptimin e specifikuar në pikën 3.2 (konfirmimet);

“Kapaciteti i kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë kapaciteti i vendosur mes palëve, i shprehur në MW;

“Çmimi i kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë çmimi i vendosur mes palëve;

“Sasia e kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë sasia e vendosur mes palëve, shprehur në MWh;

“Kontroll” do të thotë pronësia e më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të fuqisë votuese të një pale ose njësie;

“Vlerësimi i kredisë” lidhur me një njësi do të thotë sa më poshtë: i) vlerësimi afatgjatë i pasiguruar, i pavarur i borxhit publik (i pambështetur nga vlerësimi i kredisë së palës së tretë); ii) vlerësimi i kredisë të nxjerrësit të borxhit; ose iii) vlerësimi i kredisë së korporatës që i është dhënë asaj njësie në secilin rast “i” deri “iii” nga grupi i vlerësimit standard dhe të varfër (divizion i McGraw-Hill Inc.) ose Moody's Investor Services Inc.;

“Dokumentet mbështetëse të kredisë” ka kuptimin e specifikuar, që mund të përfshijë, pa kufizim, një garantues, garanci bankare, letër ndërgjegjësimi, letër kredie ose çdo marrëveshje për mbështetje kredie;

“Garantuesi i kredisë” ka kuptimin e specifikuar lidhur me një palë të specifikuar;

“Shtojca ndërkufitare” ka kuptimin e specifikuar në pikën 21(k) (përfaqësimet dhe garancitë);

“Dëmet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 12.2 (përfshirja e përgjegjëseve financiare);

“Pala që nuk përmbush detyrimet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 9.1 (pezullimi i livrimit);

“Pala livruese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 8.1 (paaftësia livruese);

“Pika e livrimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë pika e livrimit e vendosur mes palëve;

“Programi i livrimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë programi i livrimit i vendosur mes palëve;

“Data e pagesës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 13.2 (pagesa);

“EBIT” do të thotë fitimet para interesit dhe taksave që, lidhur me vitin përkatës fiskal, do të jenë të ardhurat neto të njësisë përkatëse para zbritjes së taksave të fitimit (ose çdo takse tjetër mbi të ardhurat ose fitimet në C juridiksionin përkatës të njësisë përkatëse); plus shumën e gjithë interesave dhe çdo shumë në natyrën e interesit që u ngarkohet shpenzimeve që lidhen me detyrimin financiar për paratë e marra borxh (shuma që përfshijnë borxhet e pagueshme të filialeve, si dhe instrumentet e borxheve të institucioneve financiare) të njësisë përkatëse;

“Data e hyrjes në fuqi” ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj kontrate;

“Njësia” do të thotë një individ, qeveri ose shtet ose divizion, agjenci qeveritare ose shtetërore, korporatë, partneritet ose ndonjë njësi tjetër, siç mund ta kërkojë konteksti;

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, ose çdo organizatë pasuese me autoritet të krahasueshëm mbi tarifën, afatet dhe kushtet e energjisë elektrike;

“Forca madhore” ka kuptimin e specifikuar në pikën 7.1 (përcaktimi i forcës madhore);

“Fondet nga operimi” do të thotë shuma në *cash* e gjeneruar ose e përdorur nga njësi përkatëse për aktivitetet e saj operuese;

“Fitimet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2(b) (shuma e marrëveshjes financiare);

“Mbajtës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 5.1 (livrimi dhe pranimi sipas një opsioni);

“Përqindja e interesit” ka kuptimin e specifikuar në pikën 13.5 (interesi i mospagesës);

“Kontrata individuale” ka kuptimin e specifikuar në pikën 1.1 (subjekti i kontratës);

“Letra e kredisë” do të thotë një letër e parevokueshme garancie për kredinë e pagueshme me kërkesë sipas formës dhe përmbajtjes së pëlqyeshme nga pala kërkuese dhe që nxirret nga një institucion financiar, tarifa e kredisë të të cilit është të paktën tarifa e specifikuar nga palët (tarifa e kredisë së siguruesit mbështetës të kredisë që është bankë);

“Humbjet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2(c) (shuma e marrëveshjes financiare);

“Ndryshimi i dëmshëm material” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.2 (ndryshimi i dëmshëm material);

“Arsyeja materiale” ka kuptimin e specifikuar në pikën 10.5 (përkufizimi i arsyes materiale);

“Pala që përmbush detyrimet jomospaguese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 9 (pezullimi i livrimit);

“Opsion” ka kuptimin e specifikuar në pikën 5.1 (livrimin dhe pranimin sipas një opsioni);

“Përfundimi i zakonshëm” ka kuptimin e specifikuar në pikën 10.2 (data e mbarimit të afatit dhe njoftimi 30-ditor i përfundimit);

“OST” do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit;

“OSSH” do të thotë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes;

“Pala paguese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.3(a) (pagesat lirë dhe qartë);

“Siguria e performancës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.1 (siguria e performancës);

“Pala marrëse” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.3(a) (pagesat lirë dhe qartë);

“Njësia përkatëse” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.2 (a) (vlerësimi i kredisë);

“Pala kërkuese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.1 (vlerësimi i kredisë);

“Programi” ka kuptimin e specifikuar në pikën 4.2 (përkufizimi i programit) dhe “I programuar”; dhe “Programimi” do të interpretohen sipas kësaj;

“Shitës” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale;

“Shuma e marrëveshjes financiare” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2 (shuma e marrëveshjes financiare);

“Data e marrëveshjes financiare” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale;

“Çmimi i marrëveshjes financiare” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale;

“Detyrimi i specifikuar” do të thotë çdo detyrim financiar (aktual ose i ardhshëm, i paparashikuar ose ndryshe, si principal ose garanci, ose ndryshe) për paratë e marra borxh (që përfshin borxhet e pagueshme të filialeve, si dhe instrumentet e borxheve të institucioneve financiare);

“Vlera neto e prekshme” do të thotë shuma e të gjitha kontributeve të paguara në *cash* të aksionarit në llogarinë e përbashkët të kapitalit ose në ndonjë llogari tjetër kapitali të njësisë përkatëse të vendosur për qëllimet e njësisë përkatëse dhe çdo fitim i akumuluar pa humbjet e mbajtura të akumuluar dhe asetet e prekshme, përfshirë, por pa u kufizuar me klientelën;

“Taksë” do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjobat dhe shtesat e tyre), që vendoset nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë, sipas kontratës përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme;

“Kapitalizimi total” lidhur me periudhën përkatëse do të thotë shuma e borxhit total dhe të gjitha kontributet e paguara në *cash* të aksionarit në llogarinë e përbashkët të kapitalit ose ndonjë llogari tjetër kapitali që vendoset për qëllimet e njësisë përkatëse;

“Borxhi total” lidhur me periudhën përkatëse, do të thotë shuma e detyrimit financiar për paratë e marra borxh (që përfshin borxhet që u paguhen kompanive filiale, si dhe instrumentet e borxhit të institucioneve financiare) të njësisë përkatëse;

“Periudha totale e furnizimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë periudha e furnizimit e vendosur mes palëve;

“TVSH” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.1 (TVSH);

“Shkrues” ka kuptimin e specifikuar në pikën 5.1 (livrimi dhe pranimi sipas një opsioni).

VENDIM

Nr.47, datë 24.5.2011

PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2011 PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 12, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.5.2011, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2011 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit sipas nivelit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2010 nga secili operator i licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2011 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

Nr.	Kompania	Pagesa e Rregullimit 2011 (leke)
I	Licensa per prodhim	
1	ALBANIA GREEN ENERGY sh.p.k	436,000
2	BALKAN GREEN ENERGY sh.p.k	402,000
3	EMIKEL sh.p.k.	54,000
4	AMAL sh.p.k.	15,500
5	SPAHIU-GJANC sh.p.k.	93,500
6	WONDER-POWER sh.a.	140,000
7	HEC TERVOLI	312,000
8	HIDRO ALBANIA ENERGY	27,000
9	HEC BISHNICA 1,2 sh.p.k.	24,500
10	DISHNICA ENERGJI sh.p.k.	1,500
11	ELEKTRO LUBONJA sh.p.k	2,000
12	SELCA ENERGJI shpk	19,000
13	PROJEKSION ENERGJI sh.a.	16,500
14	SAROLLI sh.p.k.	6,500
15	JUANA sh.p.k.	5,000
16	WTS energji sh.p.k.	6,000
17	MARJAKAJ sh.p.k.	6,500
18	MAKSI ELEKTRIK sh.p.k.	11,000
19	FAVINA 1 sh.p.k	56,000
20	EN.KU sh.p.k.	1,000
21	HIDROINVEST 1 sh.p.k	5,000
22	PURE ENERGY STEBLEVE sh.p.k.	5,000
23	MALIDO ENERGJI sh.p.k.	5,000
24	TEC-I VLORE	20,000
25	KESH sh.a.	13,592,000
26	TEODORI 2003 sh.p.k.	10,000
27	ENERGJI ASHTA sh.p.k	10,000
28	POWER ELEKTRIK SLABINJE sh.p.k.	10,000
29	C&S KONSTRUKSION ENERGY sh.p.k	10,000
30	HYDRO ENERGY sh.p.k	10,000
31	VENERG sh.p.k.	10,000
32	DISHNICA ENERGY sh.p.k	10,000
33	"KOKA & ERGI" ENERGY PESHK sh.p.k.	10,000
34	ANSARA KONCESION sh.p.k	10,000
35	ENERGY PLUS sh.p.k	10,000
36	HEC VLUSHE	10,000
37	ENERGY PARTNERS AL	10,000
38	HEC DUNICE	10,000
39	KORKIS 2009 sh.p.k	10,000
40	FERAR ENERGY sh.p.k	10,000
41	HEC DRAGOSHTUNJE	10,000
42	HP OSTROVICA	10,000

Nr.	Kompania	Pagesa e Rregullimit 2011 (leke)
II License per ndertim, instalim dhe prodhim		
1	MUSO HEC QYTEZE sh.p.k.	5,000
2	REMIsh.p.k.	10,000
3	ENERGO SAS sh.p.k.	10,000
4	ERS-08 shpk	10,000
5	E-VENTO srl ALBANIA sh.p.k.	20,000
6	ALBANIAN GREEN ENERGY sh.p.k.	20,000
7	HERA sh.p.k.	20,000
8	UNION EOLICA ALBANIA sh.p.k.	20,000
9	ALB WIND ENERGY sh.p.k.	20,000
10	BIOPOWER GREEN ENERGY sh.p.k.	20,000
11	ENPOWER ALBANIA sh.p.k.	20,000
III TRANSMETIMI		
1	OST sh.a	5,734,000
IV License per shperndarje/furnizim		
1	OSSHCEZ Shperndarja sh.a.	45,610,000
2	GSA sh.p.k.	144,000
3	ACR ENERGY sh.p.k.	10,000
4	KESH sh.a.	-
5	GEN - I TIRANA sh.p.k.	347,000
6	EFT-ALBANIA sh.p.k.	63,500
7	CEZ TRADE ALBANIA sh.p.k	-
V License per tregtim		
1	GSA sh.p.k.	10,000
2	SPAHIU-GJANC sh.p.k.	10,000
3	UNIVERSI sh.p.k.	10,000
4	GEN-I TIRANA sh.p.k.	-
5	ENPOWER ALBANIA sh.p.k.	10,000
6	KESH sh.a.	-
7	WONDER-POWER sh.a.	10,000
8	EFT-ALBANIA sh.p.k.	-
9	EGL ALBANIA sh.a.	10,000
10	CEZ TRADE ALBANIA sh.p.k.	157,500
11	ALPIQ ENERGY ALBANIA sh.p.k.	10,000
12	CABLE SYSTEM sh.p.k.	10,000
13	400 KV sh.p.k	10,000
14	HYDRO ENERGY sh.p.k	10,000
15	ENERGY PARTNER AL shpk	10,000
16	YLLIAD sh.p.k	10,000
17	ENERGY PLUS sh.p.k	10,000
18	RUDNAP ENERGY TIRANA sh.p.k	10,000
19	ENERGY SUPPLY -AL sh.p.k	10,000
20	HEC VLUSHE	10,000
21	HEC DRAGOSHTONJE	10,000
22	HEC DUNICE	10,000

VENDIM
Nr.48, datë 24.5.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HP OSTROVICA ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13, pika 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “g”, 5 pika 2, neneve 12, 13 dhe 14, pika “1”, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.5.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HP Ostrovica Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një periudhë 30-vjeçare.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.49, datë 24.5.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET
E DHËNIES DHE HEQJES SË STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të ERE-s (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.5.2011, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike të saj dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr.251, datë 15.3.2011, shpall të zhdukur shtetasin Halil Rustami, i datëlindjes 11.11.1932, i biri i Mustafait dhe i Bejtjes, lindur në fshatin Çermë-Biçak të rrethit të Lushnjës; si dhe caktimin si kujdestar të pasurisë së tij, vëllanë e tij, shtetasin Demir Rustami.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 27.4.2011, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasen Lejla Lamaj, e datëlindjes 20.3.1966, e bija e Sefedit dhe e Xhemiles, dhe caktimin si kujdestare të saj kërkuesen, shtetasen Alma Maja.

KËRKESË

Kërkuesja Dinora Ibrahim, e bija e Osmanit dhe e Shefikatit, e datëlindjes 13.5.1971, banuese në Shkodër, në adresën: lagjja “Salo Halili”, rruga “Ali Kelmendi”, nr.1027, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, shtetasit Sadetin Sharkiqi dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë.

KËRKUESE
Dinora Ibrahim

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 3.6.2011
Doli nga shtypi më 6.6.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 28 lekë